



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURES
AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

Lënda: LISTA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR QË DUHET DORËZUAR PËR KËRKESAT PËR LICENCË PROFESIONALE INDIVIDUALE PËR VEPRIMTARI ARKEOLOGJIKE "C", PËR MONITORIM ARKEOLOGJIK GJATË PROCESIVE ZHVILLIMORE

Kjo listë ka vetëm vlerë orientuese, në çdo rast ASHA do të vlerësojë aplikimin dhe do të përcaktojë rast pas rasti dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.

- 1. Kërkesë me shkrim në formë autobiografie teknike (Curriculum Vitae)** me të dhëna kryesore:
 - a) Emri, atësia, mbiemri, kopje të kartës së identitetit, vendlindja, adresa, vendi i punës, numri i telefonit dhe dy kopje fotografish 3x4cm.
 - b) Llojet e veprimtarisë që kërkon të kryejë, sipas kategorive dhe llojeve të përcaktuara.
- 2. Paga e tarifës së aplikimit** miratuar me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015.
- 3. Diplomë në bachelor ose master në arkeologji** dhe në fushën e trashëgimisë kulturore brenda ose jashtë vendit, e njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin. (Kopje e diplomës e noterizuar).
- 4. Eksperience të paktën 3 vjetare në arkeologji**, gjatë së cilës të ketë marrë pjesë në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar) në institucionin që ka dhënë miratimin.
- 5. Vetëdeklarim i individit mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës**, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale ku kërkon të licencohet, si dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e tij legjislacionin në lidhje me trashëgiminë kulturore
- 6. Veprimtaria e kryer nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës**, vërtetuar nga institucionet përkatëse.
- 7. Kualifikimet apo specializimet dhe kontribute të veçanta** nëpërmjet çertifikatave të lëshuara nga organet kompetente, të noterizuara.